KOLEGJI UNIVERSUM

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

dhe

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Komuna e Prishtinës

I. Qëllimi i Memorandumit

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas

II. Fushë veprimtaria.

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prishtinës** do t'iu mundësoj studentëve të Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambullantat Shëndetësore të cilat menaxhohen nga ky institucion.

Përmes këtij memorandumi do të mundësohet:

- realizimi i praktikes profesionale të studenteve te Kolegjit Universum në Repartet e Infermierisë, Fiziatrisë, Radiologjisë , Kirurgjisë, Stomatologjisë, etj,
- bashkëpunim në shkëmbimin e përvojave profesionale dhe akademike,
- realizimin i projekteve të përbashkëta hulumtuese në fushat përkatëse,
- Kolegji Universum do të realizoj konferenca dhe seminare shkencore të përbashkëta me stafin profesional dhe akademik të institucionit përkatës
- Kolegji Universum, obligohet që të paralajmëroj oraret e praktikes profesionale dhe të koordinoj realizimin me përgjegjësit e institucionit përkatës,
- Vizita e studentëve duhet të paralajmërohet me lista përkatëse dhe të përcillen nga tutorët e Kolegjit Universum
- Kolegji Universum do te kujdeset që gjatë realizimi të praktikes profesionale, mos të pengoj ecurinë e punës në institucionet përkatëse

Scanned with CamScanner

- Studentet e Kolegjit Universum duhet të respektojnë rendin shtëpiak të institucionit përkatës
- Kolegji Universum është përgjegjës për shkaktimin e çfarëdo demi gjatë realizimit të praktikes profesionale,
- Në përfundim te praktikes profesionale, studentet e Kolegjit Universum do te pajisen me dëshmi për përfundim te suksesshëm apo jo të suksesshëm të praktikes profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

III. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

V. Ky Memorandum hynë fuqi në momentin e akreditimit të programeve te lartcekura.

Prishtinë, më:

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji 'Universum'
Suat Berisha
Kryetar i Bordit Drejtues

Komuna e Prishtinës
Arben Vitia
Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Scanned with CamScanner